



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 16- 43016 / 15
Kaçanik, 28.12. 2015

Në bazë të nenit 48 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), të nenit 38.2 të Rregullore për Punë të Kuvendit, lidhur me Kërkesën e Basri Kodra, 01Nr. 16 -43016/15 parashtruar në emër të disa grupeve parlamentare opozitare, për Deklarimin e KK, kundër dy Marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë 28 dhjetor 2015, mori këtë :

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS 01Nr. 16 -43016/15, TË BASRI KODRËS, PARASHTRUAR NË EMËR TË DISA GRUPEVE OPOZITARE TË KUVENDIT TË KOMUNËS

1. Me këtë Vendim, REFUZOHET, Kërkesa e BASRI KODRËS 01Nr. 16-43016/15 e datës 14.12.2015, parashtruar në emër të subjekteve politike opozitare të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, me përjashtim të subjektit politik të LDK, për Deklarimin e Kuvendit të Komunës Kaçanik, kundër Nënshkrimit të dy Marrëveshjeve të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Kosovës: 1. Marrëveshjes për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi (Demarkacionin), dhe 2. Marrëveshjes për Krijimin e Bashkësisë së Komunave Serbe (Zajednica).
2. Refuzimi i Kërkesës së potencuar si në pikën 1. të këtij Vendimi, bëhet për arsye se nuk është në kompetenca të Kuvendit të Komunës, çështjet që i nënshkruan, Qeveria e Republikës së Kosovës.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të autoritetit mbikëqyrës MAPL, si dhe pas publikimit në Faqen Zyrtare të komunës.

Me Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës, dhe
2. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi